



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 01 mars 2012
Nr. ref.:AGJ203/12

AKTGJYKIM

në

Rastin Nr. KO 04/11

Parashtruesi

Gjykata Supreme e Kosovës

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për
shpronësimin e pronës së paluajtshme, Nr. 03/L-139**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesja e kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Baza juridike

2. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.8 të Kushtetutës, në nenet 51, 52, 53 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 75 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është kërkesa e Gjykatës Supreme për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim, Nr. 03/L-139.

Parashtrësia e parashtrueses

4. Parashtruesja pohon, së pari, që nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit të vitit 2009 janë në kundërshtim me nenin 102 (5) të Kushtetutës, i cili në pjesën përkatëse thotë:

“... Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.”

5. Parashtruesja thekson që nenet e kontestuara kërkojnë që palët në procedurë të paraqesin ankesa në gjykatë komunale, nëse vendimi është nxjerrë nga organi komunal, dhe në Gjykatën Supreme, nëse vendimi për shpronësim është nxjerrë nga Qeveria.
6. Parashtruesja më tej thekson se *“Ankesa mund të paraqitet kundër këtyre vendimeve ...”* dhe kjo do të thotë se ankesa mund të paraqitet kundër vendimeve të Gjykatës Supreme, edhe pse nuk ka dispozita për ankesë kundër një vendimi të Gjykatës Supreme të lejuar me Kushtetutë.
7. Parashtruesja pohon që palët në procedurë janë vënë në pozitë të pabarabartë; kur gjykata komunale merr një vendim, palët kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike, duke përfshirë mjetet juridike në Gjykatën Supreme, por kur vendimi i shkallës së parë merret nga Gjykata Supreme, nuk është e qartë cila është gjykata e juridiksionit të apelit. Si rrjedhojë, sipas parashtrueses, nenet në fjalë të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 janë në kundërshtim me nenin 24 (1) të Kushtetutës, i cili thotë: *“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim”*.
8. Parashtruesja më tej thekson se nenet e sipërpërmendura janë në kundërshtim me nenin 32 të Kushtetutës [E Drejta për Mjete Juridike], i cili thotë: *“Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”*. Në këtë drejtim, parashtruesja pohon që edhe pse nenet e sipërpërmendura të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 formalisht lejojnë të drejtën për ankesë, në të vërtetë, nuk ka gjykatë tjetër që do të vendoste për një ankesë të tillë përveç Gjykatës Supreme.
9. Parashtruesja më tej pohon që nenet e sipërpërmendura të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 bien ndesh me Ligjin për procedurën jokontestimore dhe me Ligjin për gjykatat e rregullta.
10. Së fundi, parashtruesja pohon që zbatimi i dispozitave të kontestuara të Ligjit të vitit 2009 do të kishte ndikim negativ në numrin e madh të lëndëve të grumbulluara në Gjykatën Supreme. Parashtruesja tha që në kohën e përpilimit të kësaj kërkesë kishte pasur rreth 200 lëndë për shpronësim në Prizren. Parashtruesja më tej thotë që *“shumë*

më shumë të tjera do të vijnë me rastin e shpronësimeve deri në Merdarë, sigurisht mijëra lëndë të tilla do të ketë. Në këso situatash do të ishte thjesht një utopi respektimi i afateve që i ka vendosur ligji, madje edhe sikur t'i kishim edhe 30 gjyqtarë shtesë, që do të merreshin vetëm me këto lëndë”.

Procedura në Gjykatë

11. Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Sekretariatën e Gjykatës Kushtetuese më 17 janar 2011.
12. Më 14 shkurt 2011, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan, kryesues, Altay Suroy dhe Iliriana Islami.
13. Më 11 maj 2011, Gjykata Kushtetuese i njoftoi Kryetarin e Gjykatës Supreme dhe Kryetarin e Kuvendit të Republikës së Kosovës për pranimin e kërkesës.
14. Më 17 qershor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga parashtruesja, në përputhje me nenin 113 (8) të Kushtetutës, t'i referohej procedurës së posaçme gjyqësore, pra lëndës në të cilin parashtruesja nuk ishte e sigurt sa i përket përputhshmërisë së ligjit të kontestuar me Kushtetutën. Gjykata Kushtetuese gjithashtu kërkoi nga parashtruesja të sqaronte nëse kërkesa e tyre ka të bëjë me Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme me ndryshime dhe plotësime (2010/03-L-205, në tekstin e mëtejshëm: Ndryshimet e vitit 2010 për Ligjin për shpronësimin e pronës së paluajtshme të vitit 2009 (2009/03-L-139).
15. Më 12 korrik 2011, parashtruesja iu përgjigj Gjykatës Kushtetuese duke sqaruar se kërkesa është parashtruar në lidhje me kushtetutshmërinë e Ligjit për shpronësim të vitit 2009. Në të njëjtën letër, parashtruesja përsëriti se dispozita të kontestuara të Ligjit të sipërpërmendur të vitit 2009 janë nenet 35, 36, 37 dhe 38.
16. Më 20 tetor 2011, Gjykata Supreme ia dërgoi Gjykatës Kushtetuese dy lëndë prej rreth dyqind e pesëdhjetë ankesave të paraqitura nga pronarët e tokës të cilët e kontestojnë vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës për vlerësimin e shumës për kompensim për pronën e shpronësuar për ndërtimin e autostradës kombëtare Vermicë-Merdarë.
17. Më 24 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese e njoftoi Qeverinë e Kosovës për parashtrimin e kërkesës.
18. Më 3 nëntor 2011, Gjykata Kushtetuese kërkoi nga Gjykata Supreme që t'i pezullonte të gjitha procedurat lidhur me lëndët në procedurë para saj që kanë të bëjnë me zbatimin e neneve të kontestuara të Ligjit për shpronësim, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

Komentet e palëve

19. Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje në këtë kërkesë as nga Kuvendi i Kosovës as nga Qeveria e Kosovës.

Dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009 dhe raporti i tyre me ndryshimet e vitit 2010 për Ligjin për shpronësim të vitit 2009

20. Ligji për shpronësim i vitit 2009 ishte ndryshuar në vitin 2010 me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së

paluajtshme, Ligji Nr. 03/L-205. Ndër të tjera, këto ndryshime i prekën, pjesërisht, të gjitha nenet e kontestuara të Ligjit për shpronësim, pra nenet 35, 36, 37 dhe 38. Megjithatë, këto ndryshime nuk e prekën substancën e kërkesës që kishte të bënte me iniciimin e procedurës në gjykatë me rastin e kontestimit të një vendimi të një organi shpronësues. Prandaj, nëse organi shpronësues në të cilin ndodhet toka është komuna, atëherë gjykata komunale është vendi i duhur për shqyrtimin e lëndës, dhe nëse organi shpronësues është Qeveria, atëherë vendi i duhur për shqyrtimin e lëndës është Gjykata Supreme.

Dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009

21. Prandaj, për hir të plotësisë dhe me qëllim të kuptimit të çështjeve të ngritura në këtë kërkesë në kontekstin e tyre aktual, teksti përkatës i dispozitave të kontestuara, të ndryshuara me Ligjin e vitit 2010, thotë me sa vijon:

KREU XI MJETET JURIDIKE

Neni 35

Ankesa Kundër Vendimit Preliminar mbi Ligjshmërinë e Shpronësimit të Propozuar

1. Nëse një Person është Pronar ose Zotërues i një Interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i procedurës së shpronësimit dhe ky person me arsye mendon se Vendimi Preliminar (ose cilado pjesë e tij) është në kundërshtim me një ose më shumë kushte të përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 4 të këtij ligji, ky person ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e Vendimit Preliminar, pjesërisht ose plotësisht.

2. Nëse Organi Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës...

Neni 36

Ankesat mbi shumën e kompensimit

1. Nëse në përputhje me nenin 11 të këtij ligji, një Organ Shpronësues nxjerr një Vendim Përfundimtar, çdo Pronar ose Zotërues i Interesit në pronën dhe/ose të drejtat të cilat janë objekt i këtij vendimi mund të paraqesë ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtimin e shumës së kompensimit dhe/ose dëmeve të cilat janë përcaktuar në vendim se do t'i paguhen atij Pronari dhe/ose Zotëruesi të Interesit.

2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës...

Neni 37

Ankesa për Kompensimin e Dëmeve të Pësuar nga Shpronësimi i Pjesshëm

1. Nëse në përputhje me paragrafin 3. të nenit 18 të këtij ligji, Vendimi Përfundimtar autorizon shpronësimin e një pjese të parcelës së pronës së paluajtshme dhe kjo rezulton, ose me arsye pritet se do të rezultojë, në humbjen e vlerës së pjesës së pa shpronësuar, Pronari i pjesës së pa shpronësuar ka të drejtë të paraqesë ankesë sipas këtij neni dhe të kërkojë nga gjykata kompetente nxjerrjen e një aktgjykimi i cili e urdhëron Organin Shpronësues që të kompensojë humbjen e vlerës, nëse – dhe vetëm për aq sa – ky kompensim nuk është paraparë në Vendimin Përfundimtar.

2. Nëse Organ Shpronësues është Organi Shpronësues i një Komune, ankesa duhet të paraqitet pranë gjykatës përkatëse komunale. Nëse Organi Shpronësues është Qeveria, ankesa duhet të paraqitet pranë Gjykatës Supreme të Kosovës...

Neni 38

Ankesa kundër ligjshmërisë së vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës

1. Nëse një Person i cili është Pronar ose Zotërues i një Interesi në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimi të Qeverisë për shfrytëzimin e përkohshëm të saj, dhe ky person me arsye mendon se vendimi nuk i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, ky person ka të drejtë të paraqesë ankesë pranë Gjykatës Supreme të Kosovës për kundërshtimin e vendimit...

22. Këtu duhet të citohet edhe një nen tjetër i rëndësishëm i Ligjit të ndryshuar për shpronësim, e ai është neni 39. Ky nen mbeti i paprekur nga ndryshimet e bëra me Ligjin e vitit 2010 dhe është i njëjti në origjinal si në Ligjin e konsoliduar. Ai përcakton që me rastin e shqyrtimit të kontesteve brenda fushëveprimit të neneve të kontestuara, nëse ka ndeshje ndërmjet dispozitave të neneve të kontestuara dhe dispozitave të Ligjit për procedurën administrative apo ndonjë ligj tjetër procedural, këto nene kanë përparësi. Ai përcakton, në tërësi, me sa vijon:

Neni 39

Kontestet tjera

1. Ankesat dhe kontestet tjera juridike nga nenet 35, 36, 37 ose 38 të këtij ligji do të zhvillohen në përputhje me ato nene. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre neneve dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative ose cilitdo ligj tjetër procedural, këto nene kanë përparësi.

2 Të gjitha kontestet tjera juridike që rezultojnë nga një veprim ose vendim i një Autoriteti Publik sipas këtij ligji i nënshtrohen e do të rregullohen në përputhje me dispozitat aplikueshme të Ligjit për Procedurën Administrative. Megjithatë, nëse një dispozitë e Ligjit për Procedurën Administrative eliminon ose e kufizon në mënyrë të paarsyeshme të drejtën e Personi të ndikuar (Person i cili është ndikuar në mënyrë specifike nga një veprim ose vendim i lartpërmendur) për të paraqitur ankesë pranë gjykatës kompetente për kundërshtim e këtij veprimi ose vendimi nuk do të zbatohet.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

23. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata Kushtetuese së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.
24. Parashtruesja e ka parashtruar kërkesën në këtë Gjykatë në pajtim me nenin 113 (8) të Kushtetutës, i cili thotë:

Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

25. Ligji për Gjykatën Kushtetuese më tej specifikon procedurën për kërkesat e parashtruara sipas nenit 113 (8), të Kushtetutës. Veçanërisht neni 51 thotë:

Neni 51

Saktësimi i kërkesës

1. Kërkesa e ngritura në pajtim me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës do të parashtrohet nga gjykata vetëm nëse ligji i kontestuar duhet zbatohet drejtpërsëdrejti në çështjen që është pjesë e lëndës në shqyrtim dhe vetëm nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit nga ana e gjykatës.

2. Kërkesa do të specifikojë cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.”

26. Së fundi, Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese ndër të tjera parashikon:

Rregulli 75

“Parashtrimi i kërkesës

(1) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtojë kërkesë në Gjykatë, në pajtim me nenin 113.8 të Kushtetutës, ex officio, ose me kërkesë të njëres palë të përfshirë në lëndë.

(2) Kërkesa duhet të theksojë përse vendimi i Gjykatës varet nga çështja e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutë. Dosja e cila shqyrtohet nga Gjykata duhet t'i bashkëngjitet kërkesës.

(3) Çdo gjykatë e Republikës së Kosovës mund të parashtojë kërkesë për të iniciuar procedurën në pajtim me dispozitat e nenit 113.8 të Kushtetutës, pavarësisht nëse një palë e përfshirë në lëndë ka kontestuar kushtetutshmërinë e dispozitës përkatëse ligjore.”

27. Shkurtime, tërësia e këtyre dispozitave do të thotë që kur gjykata që merret me një lëndë në procedurë e sipër dhe nuk është e sigurt nëse ligji që duhet të zbatohet është në përputhje me Kushtetutën, atëherë ajo gjykatë mund t'ia referojë Gjykatës Kushtetuese çështjen e përputhshmërisë së ligjit me Kushtetutën. Natyrisht, duhet të ketë procedura në të cilat çështja e parashtruar ka të bëjë me vendimin që do të merret nga gjykata referuese.
28. Nenet e posaçme të Ligjit që ngrenë dyshimin në mendjen e gjykatës duhet të përcaktohen në mënyrë të qartë dhe detajet e lëndës në shqyrtim e sipër duhet t'i bashkëngjiten kërkesës. Procedura në gjykatën e rregullt duhet të pezullohet në mënyrë automatike kur kërkesa parashtrohet në pritje të vendimit të kësaj Gjykate.
29. Prandaj, për ta vlerësuar pranueshmërinë, kjo Gjykatë duhet së pari të shqyrtojë nëse ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti nga parashtruesja në lëndën në shqyrtim e sipër dhe, së dyti, nëse ligjshmëria e ligjit të kontestuar është parakusht për marrjen e vendimit për lëndën në shqyrtim e sipër nga parashtruesja. Së treti, është me rëndësi të shihet nëse parashtruesja ka specifikuar cilat dispozita të ligjit konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën.
30. Nga parashtruesat e parashtrueses, si dhe nga teksti i dispozitave të kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009, shihet qartë që parashtruesja duhet t'i zbatojë nenet e kontestuara të atij Ligji.

31. Sa i përket kushtit të dytë, Gjykata vëren që parashtruesja i ka dorëzuar dy ankesa që asaj i janë parashtruar nga pronarët e tokës së shpronësuar në përputhje me dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009. Që të dy ankesat kishin të bënin me vendimet e Qeverisë për shpronësimin e pronës së paluajtshme në Suharekë. Gjykata Supreme ende nuk ka marrë vendime për ato raste. Gjykata Supreme ka dyshime lidhur me kushtetutshmërinë e neneve të kontestuara dhe nuk është e sigurt sa i përket përputhshmërisë së neneve me Kushtetutën. Kjo Gjykatë është e kënaqur që vendimi i parashtrueses varet nga kushtetutshmëria e neneve në fjalë.
32. Së fundi, Gjykata vëren që parashtruesja ka specifikuar cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen në kundërshtim me Kushtetutën, nenet 35, 36, 37 dhe 38.
33. Nuk ka arsye të tjera që kjo Gjykatë të konstatojë që kërkesa është e papranueshme dhe, si rrjedhojë, Gjykata konstaton që kërkesa është e pranueshme dhe do t'i trajtojë meritat e kërkesës.
34. Kjo kërkesë është rasti parë i dorëzuar nga ndonjë gjykatë në Kosovë ku gjykata e tillë nuk ka qenë e sigurt për përputhshmërinë e ligjit me Kushtetutën dhe ku, sipas nenit 113 (8) të Kushtetutës, pushteti është ushtruar. Neni 113 (8) i Kushtetutës është mjet i fuqishëm në administrimin e drejtësisë pasi u lejon të gjitha gjykatave në Kosovë të referojnë çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese. Nëse ka rast të pazgjidhur dhe nëse rasti varet nga pyetja, atëherë nuk ka pengesë për kërkesë.
35. Mund të paraqiten rrethana në të cilat gjykatat e rregullta kanë dyshime apo pasiguri nëse zbatimi i një ligji mund t'i shkelë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë, si Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj. Kjo Gjykatë është e pozicionuar brenda kornizës kushtetuese për t'iu përgjigjur pyetjeve të tilla dhe gjykatat janë të autorizuara të parashtrojnë pyetje të tilla.

Vlerësimi i meritave

36. Në esencë, Gjykata Supreme i ngrit dy çështje kryesore lidhur me dispozitat e kontestuara të Ligjit për shpronësim të vitit 2009. E para është, nga që ekzistojnë dy procedura të ndryshme gjyqësore që personat të cilëve u shpronësohet prona mund të jenë të obliguar t'i përdorin, se ka shkelje të Kushtetutës. Njëra procedurë është kur organi publik, e jo Qeveria, dëshiron ta marrë tokën. Në një rast të tillë, procedura është që ankesa të paraqitet në gjykatën përkatëse komunale ku gjendet toka. Megjithatë, nëse toka merret nga Qeveria, atëherë procedura është që ankesa të paraqitet në Gjykatën Supreme. I njëjti rregull vlen nëse ankesa ka të bëjë me vendimin preliminar mbi ligjshmërinë e shpronësimit të propozuar, shumën e kompensimit, dëmet që pësohen nga shpronësimi i pjesshëm apo ligjshmërinë e vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës.
37. Çështja e dytë që parashtruesja ngrit është se ekziston një numër i madh i lëndëve të parashtruara në Gjykatën Supreme që kanë ardhur si rrjedhojë e shpronësimit në komunën e Prizrenit dhe shumë të tjera pritet të vijnë nga shpronësimet që do të ndodhin vetëm përgjatë autostradës Vërmicë – Merdarë. Kjo Gjykatë vëren që Qeveria e Kosovës është duke ndërtuar autostradën kombëtare Vërmicë – Merdarë.
38. Sa i përket çështjes së parë, a mund të thuhet që pasi ka dy rrugë për mjete juridike për shpronësim nga dy organe të ndryshme, *ipso facto*, ka shkelje të Kushtetutës, që

shfaqet qoftë nga diskriminimi apo në ndonjë mënyrë tjetër? Kur i shikojmë personat që mund të shpronësojnë tokë në Republikën e Kosovës, përkufizimet në Ligj përkufizojnë se “Organ Shpronësues” nënkupton “një Komunë ose Qeverinë që është e autorizuar për kryerjen e shpronësimit sipas nenit 4 të këtij ligji”. Prandaj, është e qartë që edhe komuna edhe Qeveria janë organe që mund ta kryejnë shpronësimin.

39. Me rastin e shqyrtimit të nenit 4 të Ligjit për shpronësim, ekzistojnë kushte të përgjithshme që duhet të përmbushen nëse një organ shpronësues dëshiron ta shpronësojë pronën e paluajtshme. Këto kushte të përgjithshme janë:

1. Organi Shpronësues është i autorizuar të bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm pas përmbushjes së të gjitha kushteve në vijim:

1.1. shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik brenda kompetencave të tij të përcaktuara në paragrafët 2. dhe 3. të këtij neni;

1.2. qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e Shpronësimit;

1.3. përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga Shpronësimi; dhe

1.4. prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues; dhe

1.5. Organi Shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

40. Neni 4 vazhdon të thotë çfarë kushtesh të veçanta zbatohen për komuna kur ato dëshirojnë ta shpronësojnë tokën për funksione të tyre. Këto funksione, jo çuditërisht, kanë të bëjnë me mandatin e komunës që lidhen me planifikimin, ndërtimin e rrugëve komunale, objekteve publike dhe të ngjashme. Ato përkufizohen me sa vijon:

“...Organi Shpronësues i Komunës mund bëjë shpronësimin e pronës së paluajtshme vetëm nëse:

2.1. kushtet e përcaktuara në paragrafit 1. të këtij neni;

2.2. shpronësimi i prek shprehimisht të drejtat private në fushëveprimin e paragrafit 3. të nenit 3 të këtij ligji;

2.3. prona e paluajtshme përkatëse gjendet plotësisht brenda kufijve të Komunës; dhe

2.4. shpronësimi ndërlidhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë me arritjen e njërit nga qëllimet publike në vijim:

2.4.1. zbatimin e një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Komunal në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore;

2.4.2. ndërtimin ose zgjerimin e një ndërtese ose objekti i cili i do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Komunal për ushtrimin e funksionit të tij publik; ose

2.4.3. ndërtimin, zgjerimin, themelimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve në vijim, nëse kjo është e nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të komunës ose ka një përfitim tjetër të qartë publik për banorët e komunës dhe është në përputhje me kushtet e aplikueshme ligjore:

2.4.3.1. rrugët komunale (rrugët të cilat shtrihen tërësisht brenda Komunës) të cilat ofrojnë shërbime të transportit për publikun;

2.4.3.2. objektet publike të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për sigurimin e shërbimeve arsimore, shëndetësore dhe/ose të mirëqenies sociale brenda Komunës;

2.4.3.3. gypat që përdoren për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për vendbanimet brenda Komunës;

2.4.3.4. deponitë komunale dhe vendet për deponimin e mbeturinave publike;

2.4.3.5. varrezat publike komunale; ose

2.4.3.6. parqet publike komunale dhe objektet publike komunale të sportit; ose

2.4.4. përvetësimin e të drejtave sipërfaqësore të cilat i nevojiten një Autoriteti Publik Komunal për zbatimin e një licence të shfrytëzimit zejtar të mineraleve e cila i është dhënë Komunës nga KPMM në përputhje me Ligjin për Miniera dhe Minerale.

41. Kushte të ndryshme zbatohen nëse organi shpronësues është Qeveria. Këtu, funksionet kanë të bëjnë me gjëra të tilla, si rrugët ndërkomunale, hekurudhat, prodhimi dhe transmissioi i energjisë, stabilimentet dhe linjat e telekomunikacionit, pendët, rezervarët publikë të ujit, dhe të tjera. Këto përcaktohen me sa vijon:

3. Qeveria është e autorizuar ta bëjë shpronësimin e pronës për çfarëdo qëllimi tjetër të ligjshëm publik i cili nuk është përcaktuar në pikat e nën-paragrafit 2.4.1 deri më 2.4.4 të paragrafit 2 të këtij neni, nëse i plotëson kushtet e përcaktuara në paragrafin 1. të këtij neni. Për këto Shpronësime, Organi përgjegjës Shpronësues është Qeveria. Qëllime të ligjshme publike në kuptim të këtij paragrafi janë, por pa u kufizuar vetëm në këto:

3.1. zbatimi i një plani urbanistik dhe/ose hapësinor i cili është miratuar dhe shpallur nga një Autoritet Publik Qendror në përputhje me të gjitha kërkesat përkatëse ligjore;

3.2. ndërtimi ose zgjerimi i një ndërtese ose objekti i cili do të shfrytëzohet nga një Autoritet Publik Qendror për ushtrimin e funksionit të tij publik;

3.3. ndërtimin, zgjerimin ose vendosjen e infrastrukturës dhe/ose stabilimenteve të nevojshme për avancimin e mirëqenies së përgjithshme ekonomike dhe/ose shoqërore të Kosovës ose që ka një përfitim tjetër të qartë publik duke përfshirë, përveç tjerash, ndërtimin, zgjerimin ose vendosjen e:

3.3.1. rrugëve shtetërore ose ndër-komunale të cilat ofrojnë shërbime të transportimit për publikun, duke përfshirë rrugët me pagesë;

3.3.2. hekurudhave të cilat ofrojnë shërbime të transportimit për publikun;

3.3.3. punimeve, objekteve, zonave të sigurisë ose zonave për ruajtjen e karburantit ose zonave për hedhjen e mbetjeve që ndërlidhen me prodhimin, furnizimin, transmissin ose distribuimin e energjisë;

3.3.4. minierave dhe punimeve tjera, zonave të sigurisë dhe objekteve për shfrytëzimin e resurseve minerare;

3.3.5. stabilimenteve dhe linjave të telekomunikacionit, duke përfshirë linjat telegrafike dhe telefonike, dhe të rrjetit të radios dhe televizionit;

3.3.6. objekteve publike të nevojshme për qëllime të arsimit, shëndetësisë dhe/ose shërbimeve të mirëqenies sociale nga një autoritet qendror publik;

3.3.7. gypat kryesor që përdoren nga një NP për sigurimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit për publikun;

3.3.8. deponive dhe vendeve për deponimin e mbeturinave publike;

3.3.9. pendave;

3.3.10. rezervuarëve publik të ujit;

3.3.11. varrezave shtetërore për veteranë të dalluar dhe shërbyes publik të dalluar;

3.3.12. aeroportet publike, duke përfshirë zonat e sigurisë rreth aeroporteve publike;

3.3.13. parqet shtetërore publike dhe objektet shtetërore publike të sportit;

3.3.14. rezervatet mjedisore ose natyrore, duke përfshirë ato me qasje të kufizuar për publikun; ose

3.3.15. punimeve, infrastrukturës, objekteve, zonave ose vendeve të cilat janë paraparë në një Kontratë të Infrastrukturës të dhënë nga një Organ Tenderues, ose që nevojiten me arsye për zbatimin e kësaj kontrate.

3.4. mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe vendeve me rëndësi arkeologjike, historike ose shkencore, por vetëm nëse vendi është përcaktuar si i tillë në mënyrë të ligjshme me një rezolutë të Kuvendit dhe, ose:

3.4.1. pronari i pronës së paluajtshme në të cilin ndodhet monumenti ose vendi refuzon ta mbrojë atë ose për shkak të pamundësisë objektive nuk mundet ta mbrojë monumentin ose vendin; ose

3.4.2. pronari pranon ose kërkon shpronësimin e pronës përkatëse.

42. Gjykatës i duket që, me rastin e miratimit të këtij Ligji, ligjvënësit ishin të vetëdijshëm për dallimin ndërmjet shpronësimit nga komunat dhe shpronësimit nga Qeveria. Në nenet e kontestuara, Kuvendi parashikoi se do të ketë mekanizma të ndryshëm për ankesë për shpronësime nga komunat dhe për shpronësime nga Qeveria. Mund të kuptohet pse kjo është kështu. Komunat janë të kufizuara për shpronësime brenda juridiksionit të vet dhe për funksione të tyre të posaçme statutoare. Ato janë të kufizuara vetëm brenda territorit të komunës.

43. Shpronësimet nga Qeveria kanë natyrë tjetër. Në përgjithësi, këto shpronësime janë më të përqendruara në dobi të infrastrukturës kombëtare. Ka dobi të qartë për ta pasur një

organ të përgjithshëm përgjegjës për zhvillimin kombëtar dhe Kuvendi ka përcaktuar që kjo kompetencë do t'i takojë Qeverisë.

44. Prandaj, Gjykata e ka vështirë të konstatojë që ka diskriminim kundër ndokujt në lidhje me mekanizmat për “ankesë” që janë miratuar në Ligjin për shpronësim. Askujt nuk i mohohet e drejta për mjete juridike ndaj një vendimi gjyqësor për shkaqet e tyre të ankesës që shfaqen nga vendimet për ta shpronësuar pronën e paluajtshme apo për shumën e kompensimit. Për shpronësimet nga komuna, organi i shkallës së parë është gjykata komunale në të cilën gjendet prona. Për shpronësimet nga Qeveria, shkalla e parë dhe e vetme është Gjykata Supreme.

45. Gjykata Kushtetuese ka parasysh lejin e posaçëm të përfshirë në nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], i cili lejon që rasti të referohet drejtpërdrejt në Gjykatën Supreme pa të drejtë ankese, në të cilin posaçërisht përcaktohet që:

“...Me ligj mund të lejohet e drejta për të referuar një rast në mënyrë të drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme, dhe për të tilla raste nuk ka të drejtë ankese.”

46. Prandaj, kjo Gjykatë është e kënaqur që nuk ka shkelje kushtetuese në përcaktimin që ankesat kundër vendimeve të komunave shqyrtohen në gjykatat përkatëse komunale dhe në përcaktimin që ankesat kundër vendimeve të Qeverisë shqyrtohen në Gjykatën Supreme.

47. Përgjigja për argumentet lidhur me atë se si palët e prekura nga vendimi për shpronësim mund të jenë në konfuzion sa i përket procedurës që duhet të zbatohet me rastin e paraqitjes së ankesës gjendet në referencën e nenit 39 të Ligjit për shpronësim, i cili përcakton që dispozitat e neneve 35, 36, 37 dhe 38 kanë përparësi: *“1. Ankesat dhe kontestet tjera juridike nga nenet 35, 36, 37 ose 38 të këtij ligji do të zhvillohen në përputhje me ato nene. Në rast të konfliktit ndërmjet këtyre neneve dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative ose cilitdo ligj tjetër procedural, këto nene kanë përparësi.”*

48. Argumenti i dytë i parashtrueses ka të bëjë me numrin e lëndëve që mund të parashtrohen pranë saj, që shfaqen nga ndërtimi i autostradës kombëtare dhe i një sërë shpronësimeve që mund të pasojnë. Mund të ndodhë që shumë persona do të jenë të pakënaqur me vendimet për shpronësim të tokës përgjatë rrugës së propozuar. Mund të parashtrohet një numër i madh i çështjeve që e kontestojnë një vendim paraprak për ligjshmërinë e një shpronësimi të propozuar. Megjithatë, parimet që shfaqen nga këto vendime gjithashtu mund të zgjidhen mirë në rastet e para të vendosura mbi meritat. Ankesat që e kontestojnë shumën e kompensimit duhet ta përcjellin parimin e përgjithshëm të vlerës së tregut për pronën e shpronësuar, siç parashihet në nenin 15 të Ligjit për shpronësim.

Neni 15

Rregullat themelore për përcaktimin e shumës së kompensimit

1. Kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës, e cila përcaktohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore të miratuara në përputhje me paragrafin 6. të këtij neni.

49. Gjykatat e Kosovës, duke përfshirë Gjykatën Supreme, kanë mundësi ta zbatojnë këtë parim themelor të përcaktuar mirë. Ka të ngjarë që një numër i madh i rasteve nuk do t'i referohen Gjykatës Supreme, siç parasheh ajo.

50. Kjo Gjykatë ka theksuar më herët se Kushtetuta bazohet në doktrinën e ndarjes së pushteteve. Në Aktgjykimin e vet në Kërkesën KO 98/11, të 20 shtatorit 2011, lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Gjykata tha në paragrafin 44, *“Republika e Kosovës definohet nga Kushtetuta e vet si Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Ndarja e pushteteve është njëra prej bazave që garanton funksionim demokratik të shtetit. Esenca e funksionimit të pavarur dhe efektiv të këtyre degëve është imuniteti që u është dhënë njerëzve që i mishërojnë këto pushtete”*.
51. Gjykata Kushtetuese nuk do të duhej të ndërhynte lehtë në sferën e vendimmarrjes së Kuvendit kur ai vendosi për këto dispozita të kontestuara, për më tepër kur mjeti juridik për çështjen e shqyrtimit të një numri të madh të lëndëve është brenda kompetencave të parashtrueses dhe Kuvendit, qoftë në ndarjen e burimeve shtesë për Gjykatën Supreme për t'i mundësuar asaj që të merret me ngarkesën e parashikuar të punës sipas Ligjit të ri për shpronësim apo në dhënien me kohë të kompensimit të plotë për pronën e shpronësuar. Këto janë çështje plotësisht brenda juridiksionit të gjyqësorit, legjislaturës dhe Qeverisë dhe për diskutim, po qe nevoja, ndërmjet tyre. Përgjegjësia parësore për administrimin e mirëfilltë të drejtësisë i takon Qeverisë.
52. Gjykata Kushtetuese nuk mund të gjejë se ka shkelje të Kushtetutës së Kosovës as mbi atë bazë.

PËR KËTO ARSYE

Në përputhje me nenin 113.8 të Kushtetutës, nenet 51, 52 dhe 53 të Ligjit, dhe rregullin 75 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese me shumicë

VENDOSI

- I. Që kërkesa është e pranueshme;
- II. Që nenet 35, 36, 37 dhe 38 të Ligjit për shpronësim Nr. 03/L-139, janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës;
- III. Ky Aktgjykim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky Aktgjykim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Ivan Čukalović

Prof. dr. Enver Hasani